

### **Çka është Java Globale e Parave? (Global Money Week-GMW)**

Java Globale e Parave (GMW) është manifestim për ngritjen e vetëdijes lidhur me financat dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Qëllimi është të edukohen fëmijët dhe të rinjtë lidhur me financat, kursimin, krijimin e ekzistencës, punësimin, krijimin e menaxhuesve të firmave, përmes argëtimit dhe aktiviteteve interaktive. Çdo vit, i gjithë komuniteti ndërmerr masa për ta ngritur vetëdijen, për t'i inspiruar dhe nxitur të rinjtë që të fitojnë njohuri dhe mekanizma të cilët u nevojitet për ta krijuar të ardhmen personale. Java Globale e Parave (GMW) mbahet për çdo vit në gjysmën dytë të muajit mars. Ngjarjet organizohen nga shkollat, fakultetet, ministritë, institucionet financiare, institucionet rregullatore, asociacionet qytetare dhe nga të rinjtë e gjithë botës. Java Globale e Parave (GMW) iniciohet dhe koordinohet nga Organizata Ndërkombëtare për Edukimin Financiar të Fëmijëve dhe të Rinjve - Child & Youth Finance International (CYFI), e themeluar në vitin 2012.

### **Cila është tema e Javës Globale e Parave, 2016 (GMW)?**

Tema e Javës Globale të Parave (GMW), 2016 është: "Merr pjesë, Kurse me zgjuarsi!", Pse? Për shkak se: Një gjë e këtillë është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë dhe të marrin pjesë në planifikimin e shpenzimit të financave përmes krijimit të shprehive të mira nga mosha më e re, gjithnjë me qëllim që të shmanget përjashtimi financiar dhe të zhvillohen aftësitë për menaxhimin e financave të cilat do të jenë të dobishme më vonë në jetë.

### **Kur mbahet Java Globale e Parave (GMW)?**

Java Globale e Parave mbahet për çdo vit, në gjysmën e dytë të muajit mars. Në vitin 2016 do të mbahet në intervalin kohor nga data 14-20 mars.

### **Cilat janë arritjet e Javës Globale të Parave (GMW)?**

Pritshmëritë gjatë Javës Globale të Parave, për vitin 2016, janë se do të marrin pjesë mbi 7 milionë fëmijë dhe të rinj në mbi 100 vende.

Arritjet e Javës Globale të Parave gjatë periudhës së kaluar:

2015 - 5,6 milionë fëmijë dhe të rinj kanë marrë pjesë, 124 vende, 962 organizata, janë realizuar mbi 3000 aktivitete;

2014 - 3 milionë fëmijë dhe të rinj, 118 vende, 490 organizata, janë realizuar mbi 2000 aktivitete;

2013 - 1 milion fëmijë dhe të rinj nga 80 vende, 400 organizata;

2012 - 33 000 fëmijë dhe të rinj, 21 vende.

### **Kush mund të marr pjesë në Javën Globale të Parave (GMW)?**

Secili, pavarësisht nëse është nxënës, student, shkollë, fakultet, institucion financiar, institucione shtetërore apo organizata. Të gjithë së bashku mund të kontribuojmë për njohuri më të mëdha ekonomike, arsim dhe përfshirje financiare të fëmijëve dhe të rinjve.